

VENDIM
Nr. 58, datë 21.12.2022

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN “PËR
ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË VEPRIMTARINË E SUBJEKTEVE
FINANCIARE JOBANKA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr. 2, datë 17.1.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) në nenin 3, togfjalëshi “*subjektet financiare jobanka, institucionet financiare të mikrokredisë dhe institucionet e parasë elektronike*” zëvendësohet me togfjalëshin “*subjektet financiare jobanka dhe institucionet financiare të mikrokredisë*”;

b) në nenin 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 2, përmbajtja e shkronjës “a”, ndryshon si më poshtë:

“a) **“kapital rregullator”** – është kapitali që përdoret për matjen e treguesve rregullatorë dhe llogaritet si shuma algjebrike e elementeve të mëposhtme të bilancit:

i. kapital i paguar,

ii. primet e aksioneve,

iii. rezervat,

iv. diferenca rivlerësimi,

v. fitimet e pashpërndara,

vi. fitim-humbja e vitit ushtrimor,

vii. (minus) pjesëmarrjet në kapitalin e subjekteve të tjera,

viii. borxhi i varur.”

ii. në pikën 2, shkronja “d” shfuqizohet,

iii. në pikën 2, shkronja “f”, paragrafi i dytë ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Subjektet përfshijnë borxhin e varur në kapitalin rregullator, deri në 50% të shumës së elementeve të kapitalit deri më 31.12.2023 dhe, duke filluar nga 1.1.2024, deri në 33.3% të shumës së elementeve të kapitalit, vetëm nëse plotësohen kërkesat e përcaktuara në shkronjën “f” të pikës 2 të këtij neni. Për qëllime të kësaj llogaritjeje, konsiderohet shuma e elementeve të kapitalit të parashikuara në nënpikat “i” deri në “viii” të shkronjës “a” të pikës 2 të këtij neni.”

iv. në pikën 2, shkronja “f”, paragrafi i tretë, togfjalëshi “Subjekti që kërkon të përfshijë borxhin e varur në kapitalin e tij,” zëvendësohet me togfjalëshin “Subjekti që kërkon të përfshijë borxhin e varur në kapitalin e tij rregullator,” dhe në nënpikën “ii” të paragrafit të tretë të shkronjës “f” të pikës 2, togfjalëshi “të karakteristikave të borxhit të varur të përcaktuara në shkronjën “f” të këtij neni” zëvendësohet me togfjalëshin “të kërkesave dhe karakteristikave të borxhit të varur të përcaktuara në shkronjën “f” të pikës 2 të këtij neni”;

c) në nenin 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikat 2, 3 dhe 5, kudo ku parashikohet togfjalëshi “kapitalit të subjektit” zëvendësohet me togfjalëshin “kapitalit rregullator të subjektit”,

ii. në pikat 3 dhe 5, togfjalëshi “veprimtarinë e faktoringut, të qirasë financiare, dhe institucioneve të parasë elektronike” zëvendësohet me togfjalëshin “veprimtarinë e faktoringut dhe të qirasë financiare”,

- iii. në pikën 4, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me përmbajtjen e mëposhtme:
“c) pjesëmarrjet në kapitalin e subjekteve të tjera, të cilat janë zbritur nga kapitali rregullator i subjektit.”;
- d) në nenin 10 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 2, shkronjat “a” dhe “b”, togfjalëshi *“me kapitalin,”* zëvendësohet me togfjalëshin *“me kapitalin rregullator,”*;
- ii. në pikën 2, shkronja “b”, togfjalëshi *“nuk dubet të jetë më shumë se 40% (dyzetë për qind) e kapitalit”* zëvendësohet me togfjalëshin *“nuk dubet të jetë më shumë se 40% (dyzetë për qind)”*;
- e) kudo në nenin 11, pika 2, togfjalëshi *“raporti i kapitalit”* zëvendësohet me togfjalëshin *“raporti i kapitalit rregullator”*;
- f) në nenin 12, shkronjat “d” dhe “e”, togfjalëshi *“të kapitalit të subjektit”* zëvendësohet me togfjalëshin *“të kapitalit rregullator të subjektit”*;
- g) në nenin 21, pikat 1 dhe 2, togfjalëshi *“kapitalit të subjektit”* zëvendësohet me togfjalëshin *“kapitalit rregullator të subjektit”*;
- h) në nenin 22, pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:
“3. Subjektet financiare jobanka të licencuara për ushtrimin e qirasë financiare, zbatojnë kërkesat e parashikuara në nenet 16 dhe 17 të kësaj rregulloreje, për ekspozimet e ristrukturuara dhe ekspozimet që do të fsihien nga bilanci.”;
- i) në nenin 25, pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:
“3. Subjektet zbatojnë kërkesat e parashikuara në nenet 16 dhe 17, të kësaj rregulloreje, për ekspozimet e ristrukturuara dhe ekspozimet që do të fsihien nga bilanci.”;
- j) Kreu VI “Administrimi i rrezikut në institucionet e parasë elektronike” që përfshin nenet 27-29, shfuqizohet;
- k) në nenin 35, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 1, shkronja “b”, hiqet togfjalëshi *“, përfshirë edhe kërkesat për agjentët”,*
- ii. në pikën 1, shkronja “j”, togfjalëshi *“subjekti financiar jobankë, institucioni financiar i mikrokredisë ose institucioni i parasë elektronike”* zëvendësohet me togfjalëshin *“subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë”*;
- l) në nenin 36, pika 1, shkronja “i”, togfjalëshi *“kur raporti i kapitalit”* zëvendësohet me togfjalëshin *“kur raporti i kapitalit rregullator”*.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi, më 1 mars 2023.

KRYETAR
Gent Sejko